

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN LIVADHJA

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **komunën e Livadhja**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 31.03.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 83, datë 20.06.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 241/7, datë 20.06.2015, i ka rekomanduar z., Iradhisi Dalani Kryetar i komunës Livadhja, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje: Përdorimi efektiv i fondeve të buxhetit për investime.

Për sa evidentuar më sipër në lidhje me investimet rezulton se për vitin 2013 dhe 2014 në komunën Livadhja janë planifikuar 10 objekte investimi nga të cilat 2 rezultojnë të realizuara. Mosrealizimi i investimeve sipas planifikimit të bërë në fillim të çdo viti, evidenton një punë të pa mjaftueshme të administratës së komunës në planifikimin dhe realizimin e investimeve, duke mos u plotësuar kërkesa e komunitetit për këto investime, në kundërshtim me vendimet e këshillit të komunës nr. 3, datë 12.01.2012 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2012”, nr. 8, datë 25.02.2013“ Për buxhetin e vitit 2013 dhe nr 6, .datë 17.03.2014“Për buxhetin e vitit 2014”.

Rekomandimi: Nga ana e Komunës të merren masa në vazhdimësi për realizimin e investimeve, që ato të jenë efektive dhe në shërbim të Komunitetit.

Në vijimësi

2.Gjetje: Komuna Livadhja (Zyra Financës), nuk ka zbatuar procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve debitorë sipas bilancit kontabël të mbartura nga vitet e mëparshme gjendje në fund të vitit 2014 në vlerë **20,732,201 lekë**, për taksën e tokës Bujqësore.

Rekomandim: Komuna Livadhja (Zyra e Financës) të marrin masa duke zbatuar të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **20,732,201 lekë**.

Brenda datës 30.09.2015

3.Gjetje: Komuna Livadhja është penalizuar nga gjykata për largime nga puna të punonjësve për zgjidhje të kontratës së punës në kundërshtim me nenet 153 dhe 154 të ligjit nr. 7961, datë 11.7.1995 “*Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar, dhe me pikën 62 të UMF nr. 2 datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, duke rënduar padrejtësisht shpenzimet e institucionit në vlerën 260,100 lekë, pavarësisht ndjekjes në rrugë ligjore dhe konstatimeve nga ana e NJQV të Vendimeve të gjykatës për dëm shpërblimet për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, përgjegjësia është tërësisht e institucionit, i cili nuk ka analizuar të gjitha vendimet, që kanë sjellë dëm efektiv për buxhetin e shtetit dhe nuk ka kërkuar nxjerrjen e përgjegjësive administrative për shkaktarët.

Rekomandim: Komuna Livadhja të nxjerrë përgjegjësit për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të punonjësve me Institucionin, për shkaqe të pa argumentuara dhe të pambështetura në dispozitat ligjore në fuqi, pasi për shkak të këtyre veprimeve, institucioni detyrohet të ekzekutojë vendime gjyqësore duke paguar shumën **260,100 lekë**.

Menjëherë

4.Gjetje: Komuna Livadhja (Zyra e Financës), në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011” Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik”në zbatim të ligjit 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, për vendosje dhe stolisja e pemës së vitit të ri në vlerë **15,000 lekë**, nuk është bërë hyrje as dalje, nuk ka preventive apo situacione për parashikimin dhe shpenzimin e kryer në fakt.

Rekomandim: Komuna Livadhja të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **15,000 lekë**.

Brenda datës 30.09.2015.

5.Gjetje: Komuna Livadhja (Zyra e Financës), në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 1/1datë 19.02.2013 Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2013 pika 16 dhe 18.... dhe kriteret e VKM nr. 929 datë 17.11.2010 i ndryshuar për fondin e veçantë, organizim feste në vlerë **220,000 lekë** është organizuar një drekë gjithsej prej afër 250 veta, pa miratuar programin në lidhje me aktivitetin, listën emërore të personave.

Rekomandim: Komuna Livadhja të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbartimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **220,000 lekë**.

Brenda datës 30.09.2015

6.Gjetje: Komuna Livadhja (Zyra e Financës), në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin”, ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006, VKM nr. 248 datë 10.04.1998, të ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 “Për miratimin e Planit Kontabël të Organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore e Lokale si dhe njësisive që varen prej tyre” .

Rekomandim: Komuna Livadhja (Zyra e Financës), të marrin masa për mbajtjen e kontabilitetit në përputhje me kërkesat e dispozitave ligjore duke saktësuar edhe veprimet kontabël të bilancit për vitin 2014 për parregullsitë e konstatuara.

Brenda datës 30.09.2015

7.Gjetje 10: Në Komunën Livadhja Sarandë të ardhurat nga taksat e tarifave vendore për vitin 2013 janë parashikur 6,924 mijë ndërsa realizimi është 6,595 mijë lekë, më pak për 324 mijë lekë ose 95 %, për vitin 2014 janë parashikuar 11,610 mijë lekë ose rreth 4.700 mijë lekë më shumë se viti 2013, ndërsa realizimi është për 13,128 mijë lekë ose 113%.

- Taksa e pasurisë paluajtshme për vitin 2012 janë arkëtuar **më pak se programimi 553 mijë lekë** nga e cila taksë toke 275 mije lekë dhe taksë ndërtese 278 mije lekë, ndërsa për vitin 2013 janë realizuar në nivel më të ulët se viti mëparshëm duke **arkëtuar më pak 584 mijë lekë** nga e cila taksë toke 292 mijë lekë dhe taksë ndërtese 292 mijë kundrejt programimit në shumën 600 mijë lekë, nga e cila taksë e tokës bujqësore 300 mijë lekë **dhe** taksë ndërtese 300 mijë lekë.

Nga mosrealizimi i parashikimi i drejtë i takse dhe tarifave për të dy vitet, rezultojnë **të ardhura të munguara në buxhetin e komunës në shumën 2,641,7 mijë lekë**.

Rekomandim: Strukturat përgjegjëse në komunën Livadhja të organizojnë punën dhe konkretisht:

- në bashkëpunim me biznesin të hapen regjistrat e taksave vendore për subjektet fizike e juridike, në mënyrë manuale.

Në vijimësi

8.Gjetja: Nga ana e Komunës Livadhja nuk rezulton të jenë kryer studime urbanistike pjesore apo të përgjithshme për zhvillimin e teritorit sikurse përcaktohet në ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e Teritorit” për hartimin e studimeve urbanistike pjesore, masterplaneve të zhvillimit territorial, si dhe nuk rezulton të jetë hartuar e miratuar rregullore uniforme në zbatim të pikës 3, neni 13 i VKM nr. 502, datë 13.07.2011 ”Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit dhe zhvillimit të teritorit”.

Rekomandimi: Nga ana e Komunës të merrren masa për ngritjen e grupeve të studimeve urbanistike, pjesore, të përgjithshme për detajimin e PPV dhe hartimin e rregullores uniforme në zbatim të *pikës 3, neni 13 i VKM nr 502, datë 13.07.2011 ”Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit dhe zhvillimit të teritorit”*.

Në vijimësi

9.Gjetje: Nga ana e Komunës Livadhja për pronat e përfituara sipas VKM nr. 1489, datë 12.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të inventarit të pronave që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore komuna Livadhja të Qarkut të Vlorë” dhe VKM nr. 895, datë 11.06.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore komuna Livadhja të Qarkut të Vlorë”, nuk ka kryer regjistrimin e tyre në ZVRPP Sarandë, veprime në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.11.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, neni 18 i ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore, neni 45 i ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ligjit nr. 9385 datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar dhe nenin 193 të Kodit Civil, për rrjedhojë nuk janë pasqyruar në kontabilitet në përputhje me kërkesat e Udhëzimit e MF nr. 30, datë 27.12.2011

“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Rekomadim: Komuna Livadhja të marrë masat për përmbylljen e fazës së regjistrimit për kalimin në pronësi dhe transferimit të pronave të paluajtshme Shtetërore në favor të komunës Livadhja me VKM nr. 1489, datë 12.11.2008 dhe të kërkojë në ZVRPP Sarandë procedurat e regjistrimit të pasuritë dhe pronat e transferuara me VKM nr. 895, datë 11.06.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore komuna Livadhja të Qarkut të Vlorë” dhe pasi të ketë përfunduar regjistrimin e pasurive në ZVRPP Sarandë, të nisë inventarizimin fizik dhe përfshirjen e vlerës në pasqyrën përkatëse të evidencës kontabël, për zërat “toka, pyje, kullota, livadhe, troje, terrene”, objekte të ndryshme duke i pasqyruar në bilancin e vitit 2015.

Brenda datës 30.09.2015

10.Gjetje: Nga auditimi del se dhe pse ka mbi 6 vjet që në bazë të VKM nr. 895, datë 11.06.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore komuna Livadhja të Qarkut të Vlorë”, Komuna Livadhja ka marrë në dorëzim një sipërfaqe prej 4,850,5 ha fond pyjor dhe kullor e përbërë sipas kategorisë të mëposhtme: Pyje gjithsej 2,830,5 ha; nga kjo 1,650,5 ha cungishte dhe 1,173 ha shkurre; 2020 ha kullota dhe 281 ha toka inproduktive sipas procesverbalit datë 05.08.2008 ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Sarandë dhe Komunës Livadhja që është bërë dorëzimi i pronave në pronësi të kësaj komune, nuk janë vënë në shfrytëzim të plotë për vitet 2012-2013, 2013-2014 dhe 2014-2015 janë krijuar të ardhura nga tarifatat e përdorimit të kullotave dhe kositje, nga kapaciteti i kullotave në juridiksionin e kësaj Komune (Ilogaritur sipas tarifave të VKM nr. 632, datë 11.6.2009 “Për miratimin e Tarifave të Përdorimit të Kullotave dhe Livadheve për Kullotje dhe Kositje”.

Rekomadim: Komuna Livadhja të marrë masat, që pas përfundimit të procesit të regjistrimit të verë në efikasitet këto prona duke shfrytëzuar kapacitetin kullor.

Brenda datës 30.09.2015

11.Gjetja: Nga ana e Komunës Livadhja në strukturën e INUV në vitin 2013 është emëruar Agronom, në kundërshtim me nenin 11, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”. Për vitin 2013 janë konstatuar 2 raste ndërtimes pa leje dhe në raste 33 të tjera janë konstatuar konflikte pronësie, ndërsa për rastet e ndërtimit pa leje nuk janë zbatuar sanksione në zbatim të ligjit për kundravajtjet administrative, nuk ka vendosur gjobë dhe nuk ka vendim prishje për këto ndërtimet pa leje, në kundërshtim me nenin 75 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën” dhe me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit” dhe me nenin 15/a të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, “Sanksionet”, ndryshuar me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007 etj.

Rekomandimi: Nga ana e Komunës të merren masa për kontrollin e teritorit për ndërtimet pa leje, dhe në kundërshtim me kondicionet urbane dhe për emërimin e punonjësve të INUV .

Në vijimësi

12.Gjetje: Veç të tjerave është pasur në qendër të vëmendjes transparenca me publikun dhe konkretisht:

- Në KLSH janë protokolluar ankesa e qytetares E.Sh me nr. 1134, datë 12.10.2012 të cilët kërkojnë se për pronat e tyre të kthyer me vendime komisioni të pronave kryhen veprime arbitrare nga komuna Livadhja. Duke i vlerësuar me objektivitet këto ankesa u bë verifikimi i tyre në komunën Livadhja dhe ZVRPP Sarandë dhe doli.

Komuna Livadhja për përfitim prone më tepër pa dokumente pronësie të vjetër, por me vendime gjyqësore për njohje fakti ka paditur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, AKKP Tiranë, E.Sh dhe B.J, me objekt: “Pavlefshmëri relative të pjeshme të VKKKP nr. 15 datë 30.06.1998 të KKKP Sarandë, ndryshuar me vendimin nr. 1099 datë 20.05.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë si dhe plan vendosjes, duke i anuluar ato dhe kthimin në gjendjen e mëparshme;

- Në KLSH janë protokolluar ankesa e E.Sh me nr. 217, datë 22.03.2013 për dhënie me qira Gurore nga komuna Livadhja të një subjekti privat e cila ushtron aktivitetin e vet në mënyrë të jashtë ligjshme në pronat e tyre.

Nga verifikimi del se nga komuna Livadhja nuk disponohet asnjë kontratë e tillë qiraje.

Për të dy rastet bazuar në të dhënat e trajtuar më lart konkludojmë se ankuesit nuk kanë të drejtë për problemet e ngritura meqenëse çështja është në proces gjyqësor.

- Në KLSH ka paraqitur ankesë L.A me nr. 996, datë 02.12.2013, por nga shqyrtimi i praktikës del se problemet e ngritura prej tij janë për komunën Markat dhe jo për komunën Livadhja.

Rekomandimi: Ankuesve E.Sh dhe E.Sh tu kthehet përgjigje që: Përsa është shqyrtuar dhe verifikuar kërkesa juaj drejtuar institucionit të KLSH ju sqarojmë se pronësia është proces gjyqësor kërkuar nga Komuna Livadhja dhe si e tillë është gjyakata e cila do të shprehë të drejtën për problemin e ankimuar.

- Në KLSH ka paraqitur ankesë M.K, fshati Kulluricë protokolluar me nr. 241/2, datë 27.03.2015. Pronësia për të cilën pretendohet nga ankuesi M.K rezulton të jetë përfituar me Vendimin e Komisionit të KPP Sarandë nr. 53, datë 13.12.2000 dhe ka në themel vendimin e gjykatës nr. nr. 271, datë 10.05.2000 me objekt: Vërtetim i faktit Juridik të pronësisë ish-Pronarit H.Ç për një sipërfaqe 590 dynym në vendin e quajtur “Karamato”. Një pjesë e studimit të miratuar nga KRRTR Sarandë nr. 315, datë 22.06.1998 rezulton në pronën Kullotë përfituar nga H.Ç studim i miratuar më parë se sipërfaqja kullotë të kthehej me vendim komisioni. Familja D. ka vetëm pretendim pronësie dhe deri në momentin e auditimit nuk ka përfituar pronë me dokumentacion ligjor.

Rekomandim: Të verifikohet VKKP nr. 53, datë 13.12.2000 nga AKPP për ligjshmërinë tij, bazuar në vendimin e gjykatës nr. nr. 271, datë 10.05.2000 me objekt: Vërtetim i faktit Juridik të pronësisë ish-Pronarit H.Ç për një sipërfaqe 590 dynym në vendin e quajtur “Karamato”.

Rekomandim: Ankuesit M.K ti kthehet përgjigje që: Përsa është shqyrtuar dhe verifikuar kërkesa juaj drejtuar institucionit të KLSH ju sqarojmë se pronësia prej 590 dynym është përfituar me vendim gjykate me vërtetim fakti Juridik dhe si i tillë duhet të drejtoheni AKKP Tiranë dhe Ministrisë së Drejtësisë për verifikimin e këtij vendimi.

Menjëherë.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Zyra e Financës së Komunës, të marrë masa duke kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **1,349,650 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, konkretisht:

1.Gjetje: Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave u konstatuan pagesa të kundërligjshme në vlerën **765 240 lekë**, në kundërshtim me *VKM nr. 518, datë 16/08/2012 dhe VKM nr. 586, datë 17.07.2013*, klasifikimi i funksioneve, sipas grupimit të njërive të qeverisjes vendore dhe kategorizimit të vendeve të punës sipas tabelës së pagave vitit 2012 dhe vitit 203 është bërë në kundërshtim me VKM nr. 1619, datë 02.07.2008, i ndryshuar..

1.Rekomandim : Të merren nga ana e Komunës për arkëtimin në rrugë ligjore të detyrimit të përcaktuar për **8 subjekte në vlerën 765,240 lekë si më poshtë:**

1.N.D, P/Zyrës Tatim-Taksave vlera *150,580 lekë*.

2. K.P: Inspektor Tatim Taksa vlera *65,630 lekë*.

3. K.S ;P/Zyrës së IUNV(Inspektor) vlera lekë *161,240 lekë*.

4. S.N: P/Zyrës së Shërbimeve sociale vlera *162,940 lekë*.

5.S.P : Inxhinjer Ndërtimi emëruar P/Zyrës së Shërbimeve vlera *163,440 lekë*.

6. S.P: Inxhinjer Ndërtimi, funksioni Anëtar Këshilli vlera për 6 muaj *42,000 lekë*

7. E.P: Inspektore tatim-taksa vlera *19,170 lekë*,

8. J.Ç: Listë pagesë e muajit Janar 2014 e pa kundruar përfituar *më tepër 240 lekë*.

Brenda datës 31.12.2015

2 Gjetje: Nga auditimi u evidentuan dhënia me qira e kullotave dhe pyjeve me referencë ligjore në zbatim VKM nr. 632, datë 11.06.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje e kositje”, bazuar dhe në vendimet e këshillit të komunës për çdo vit të lidhjes së kontratës dhe konkretisht sipas Vendimeve nr. 36, datë 27.01.2012, nr. 66, datë 21.01.2013 dhe nr. 93, datë 26.02.2014 “Për taksat dhe tarifatat vendore respektivisht për vitet 2012-2013; 2013-2014 dhe 2014-2015 dhe konkretisht.

Duke kryer llogaritjet për sipërfaqet e marra sipas kontratës dhe për të gjitha kontratat del një diferencë prej 187,760 lekë.

Gjithashtu e njëjta praktikë është ndjekur edhe për periudhat Tetor 2013 deri Maj 2014 dhe Teor 2014 deri Maj 2015, duke u llogaritur një diferencë prej 194,050 lekë për vitin 2013 dhe 192,600 lekë për vitin 2014 dhe në total për të tre vitet del diferenca për tu arkëtuar 674,410 lekë, sipas Aneksit nr. 1 dhe 2 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit .

2.1 Rekomandim: Nga ana e Komunës Livadhja të merren masa për arkëtimin në rrugë ligjore të detyrimit të përcaktuar për **71 subjekte në vlerën 674,410 lekë sipas Aneksit nr. 2**

C. MASA DISIPLINORE

-Mbështetur në germa “e” dhe “ç”, neni 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale tip, i rekomandojmë Kryetarit të Komunës, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore nga “**Vërejtje**” deri “**Ndërprerje të marrëdhënie të punës**”, sipas shkallës së përgjegjësisë, për këta persona:

1. z. P.N me detyrë zv/kryetar i Komunës dhe P/Zyrës së Financës Komuna Livadhja, Për veprime dhe mos veprime të kryera në lidhje me pagesat e kryera **për 7 punonjës** në vlerën prej **765 240 lekë**, në kundërshtim me **VKM nr. 518, datë 16/08/2012 dhe VKM nr. 586, datë 17.07.2013.** dhe për shkelje të konstatuara në lidhje me veprimet e kryera në arkë duke depozituar shuma tej limitit të përcaktuar.

2. z. A.K me detyrë zv/kryetar i Komunës dhe P/Zyrës së Tokës Komuna Livadhja, Për veprime dhe mos veprime të kryera në lidhje me regjistrimin e pronave në ZVRPP Sarandë të fituara me VKM VKM nr. 1489, datë 12.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të inventarit të pronave që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore komuna Livadhja të Qarkut të Vlorë” dhe VKM nr. 895, datë 11.06.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore komuna Livadhja të Qarkut të Vlorë”, (trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

3. z. – K.S me detyrë inspektor i pyjeve komunal;

Për veprime dhe mos veprime të kryera në lidhje me dhënien me qira të pyjeve e kullotave pa u regjistruar në emër të komunës Livadhja pronat e fituara me VKM VKM nr. 1489, datë 12.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të inventarit të pronave që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore komuna Livadhja të Qarkut të Vlorë” dhe VKM nr. 895, datë 11.06.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore komuna Livadhja të Qarkut të Vlorë”, në kundërshtim me nenin 193 të Kodit Civil, (trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

4. z. K.P me detyrë inspektor i zyrës së Tatim Taksave të komunës;

5. znj. A.Ç me detyrë inspektore e zyrës së Tatim Taksave të komunës; dhe

6. z. Z.K me detyrë përgjegjës zyre në i Tatim Taksave të komunës;

Për veprime dhe mos veprime të kryera në lidhje me shkeljet e trajtuara rast pas rasti dhe **paraqitjen e një performancë të ulët** të administratës fiskale të Komunës Livadhja për:

Nga komuna Livadhja, me shkresë nr.55 prot., datë 09.07.2015 e protokolluar në KLSH me nr. 241/8 prot., datë 13.07.2015, ka kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit te detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Qemal Meta, Agim Mandri, Xhovan Domi dhe Jonild Hoxhaj, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

